



ETIKA E BIZNESIT

Etika, koncepte bazë



MODULI 2

Moduli 2. Etika, koncepte bazë

1. Konceptet bazë për etikën në përgjithësi;
2. Gjykimet dhe llojet e tyre;
3. Standardet morale, vecorite e tyre;
4. Lidhjet midis standardeve morale dhe shoqërisë;
5. Skema e arsyetimit moral;
6. Vlerësimi i përgjegjësisë morale;
7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti i saj.

6. Përgjegjësia morale

- Deri tani, krahas koncepteve për etikën, është trajtuar arsyetimi moral, që synon:
 - dhënien e gjykimit për një veprim (sjellje, politikë apo institucion) - në se është moralisht i drejtë apo i gabuar
- Arsyetimi moral, nuk është qëllim në vetvete, por duhet të synjë – përcaktimin e përgjegjësisë morale
- Gjykimi i përgjegjësisë morale të individit, që rrjedh nga një veprim i gabuar (i padrejtë), ka për qëllim:
 - të vlerësojë shkallën më të cilën individit meriton fajësimin apo ndëshkimin dhe për pasojë do të duhet të paguajë dëmshpërblim për dëmtimin që ka shkaktuar.

6. Përgjegjësia morale

- Jo gjithmonë Individët janë moralisht përgjegjës për veprimet e tyre të padrejta apo dëmtuese.
 - Për shembull, një person pa e ditur se çfarë bën, shkakton një dëmtim mbi një qenie njerëzore të pafajshme.
- A mund të mendojmë se një individ është moralisht përgjegjës për dëmtimin?
- Personi justifikohet nga virtuti i mosdijes së tij.
- Kur një individ do të jetë moralisht përgjegjës dhe duhet të fajësohet për kryerjen e një veprim të padrejtë?

6. Përgjegjësia morale

- Individu është moralisht përgjegjës vetëm për ato veprime dhe efekte të dëmtimeve që mund të parashikoheshin
- (1) për të cilat personi ka patur njohuri dhe i ka kryer apo shkaktuar lirisht,
 - (kur kryerja e veprimeve është moralisht e gabuar), ose
- (2) për të cilat personi ka patur dijeni dhe lirshëm nuk i kryer ose ka penguar kryerjen e tyre,
 - (kur moskryerja ose pengimi është moralisht e gabuar).
- Përgjegjësia morale e individit që shkakton një dëmtim të padrejtë eliminohet plotësisht në kushtet e:
 - (a) injorancës ose padijes dhe
 - (b) paaftësisë/pamundësisë.

6. Pergjegjësia morale

- A mundet që Injoranca dhe paaftësia ta shfajësojë individin?
- Jo gjithnjë.
 - Për shembull - kur individ i në mënyrë të qëllimshme nuk merr njohuritë e duhura në lidhje me një çështje të caktuar.
- Një individ mund të mos ketë njohuri si për faktet ashtu edhe standardet përkatëse morale.
 - Individ i di që dhënia e rryshfetit nuk është një veprim i mirë (**SM**), por ai nuk ka dijeni për faktin që duke lënë bakshish për një zyrtar të doganës, në fakt ai po i jep atij rryshfet pikërisht për të shmangur/zvogëluar disa detyrime doganore (**fakti përkatës**)

6. Përgjegjësia morale

- **Injoranca apo padija për faktin**, përgjithësisht e eleminon përgjegjësinë morale, pasi një individ nuk mund të detyrohet të bëjë dicka për të cilën ai nuk ka asnjë kontroll.
 - Mos marrja e dijenive përmes neglizhencës ose me qëllim përbën një përjashtim nga ky parim pasi kjo mos-dijeni mund të kontrollohet.
- **Mosdijenja për standardet përkatëse morale** përgjithësisht e mënjanon përgjegjësinë pasi një person nuk është përgjegjës për mos-plotësimin e detyrimeve, për të cilat ai nuk është në dijeni

6. Përgjegjësia morale

- **Paaftësia (pazotësia)** mund të vijë nga rrethanat e brendëshme ose edhe ato të jashtëme.
 - Individit mund t'i mungojnë: fuqia, aftësitë profesionale, mundësia apo burimet për të vepruar
 - Individit mund të pengohet për të vepruar, ose është me paaftësi mendore dhe nuk i kontrollon veprimet e tij
- Paaftësia (pamundësia) e eliminon përgjegjësinë për faktin që personi nuk mund të ketë detyrimin moral të bëjë ose të mos bëjë një veprim për të cilin ai nuk ka kontroll.

6. Përgjegjësia morale

- Si rregull i përgjithshëm në të gjitha kushtet e tjera individi do të ishte moralisht përgjegjës
- Megjithatë, edhe kur individi është moralisht përgjegjës, niveli i përgjegjësisë morale mund të jetë i ndryshëm:
- Disa nga faktorët zbutës (lehtësues) të përgjegjësisë morale:
 - (1) **rrethanat e paqartësisë** – një person është i paqartë, dhe jo tërësisht i pasigurtë për atë që ai po bën
 - (ndikimi - në njohurinë e individit)
 - (2) **rrethanat e vështirësisë** – një person e ka të vështirë por jo të pamundur të shmangë atë që po bën
 - (ndikimi - tek liria e personit);

6. Përgjegjësia morale

- (3) rrethanat që minimizojnë përfshirjen - por që nuk e mënjanojnë plotësisht përfshirjen e personit në një veprim të caktuar
 - (ndikimi - në masën në të cilën personi ka shkaktuar ose ka ndihmuar të shkaktojë dëmtimin).
- Rrethanat (1); (2); dhe(3) e zvogëlojnë përgjegjësinë e personit në varësi të:
- (4) seriozitetit apo rëndësia e gabimit/fajit (dëmtimit).

6. Pergjegjësia morale

- (1) rrethanat mund të prodhojnë paqartësi për shumë çështje.
- Një individ mund të jetë shumë i bindur se kryerja e një veprimi të caktuar është gabim, megjithatë ai ende mund të ketë dyshime:
 - për disa fakte të rëndësishme,
 - rreth standardeve morale, ose
 - për shkallën e seriozitetit të gabimit që bëhet nga kryerja e veprimit.
- Për shembull, një zyrtar, të cilit mund t`i kërkohet t`i japë informacione të pronësisë një konkurenti, mund të jetë i sigurtë se ky veprim përbën një gabim, megjithatë ai mund të ketë paqartësi për shkallën apo nivelin e gabimit që kryhet nga ky veprim.

6. Përgjegjësia morale

- (2) një person mund ta ketë të vështirë të shmangë kryerjen e disa veprimeve:
 - mund të kërcënohet apo të detyrohet;
 - shmangja e veprimeve do t`i shkaktonte atij kosto të rënda.
- Menaxherët e nivelit të mesëm shpesh ndodhen nën presionin ose kërcënimin e eprorëve të tyre për të arritur objektiva jo-realiste të prodhimit ose për të ruajtur sekretin e informacioneve që kanë të bëjë me shëndetin edhe pse kryerja e këtyre veprimeve është jo-etike.
- Kur presionet ndaj menaxherit janë të mëdha, mund të thuhet se përgjegjësia e tij morale zvogëlohet.

6. Përgjegjësia morale

- **(3) përgjegjësia mund të zbutet nga rrethanat që e zvogëlojnë përfshirjen aktive apo direkte të individit në veprimin që shkakton një dëmtim apo fyerje.**
- Një inxhinjer mund të kontribuojë në prodhimin e një produkti të pasigurte, kur ai harton me dashje një projekt të pasigurt.
 - Pjesëmarrje aktive
- Inxhinjeri mund të jetë në dijeni të faktit që një projekt i hartuar nga një koleg i tij është i pasigurtë, por ai në mënyrë pasive nuk bën asnjë veprim duke arsyetuar se “nuk është puna etij”.
 - nuk ka pjesëmarrje aktive në shkaktimin e dëmtimeve të ardhëshme.

6. Përgjegjësia morale

- (4) Megjithatë, masa apo niveli në të cilën të tre këto rrethana lehtësuese mund të ulin përgjegjësinë e personit për një veprim të gabuar do të varet nga:
 - serioziteti/rëndësia e gabimit.
 - në qoftë se pasoja nga kryerja e një veprimi është shumë e madhe (e rëndë), atëherë as presionet e mëdha, e as përfshirjet minimale nuk mund ta zvogëlojnë në mënyrë substanciale PM për veprimin.
 - Shembull – Edhe kur punëdhënësi e kërcënon punëmarrësin me pushim nga puna dhe e detyron për shitjen e një produkti të përdorur, për të cilin punëmarrësi ka njohuri se përdorimi i tij mund të shkaktojë deri vdekje - do të ishte gabim që punëmarrësi t`i bindej këtij urdhëri edhe pse nga humbja e punës ai do të kishte pasoja për jetesën.

6. Përgjegjësia morale

- Për të përcaktuar përgjegjësinë morale të dikujt në rastin e kryerjes së një veprimi moralisht të gabuar duhet të mbahen parasysh:
 - paqartësitë,
 - presionet,
 - shkallen e përfshirjes
- Dhe të gjitha të peshohen në raport me seriozitetin e gabimit/dëmtimit që shkaktohet.

6. Përgjegjësia morale

■ Permbledhje- PM:

Së pari një individ është moralisht përgjegjës për veprimet e padrejta që ai kryen dhe për efektet dëmtuese të tyre, kur veprimi bëhet

- *me dashje dhe*
- *lirshëm.*

■ Së dyti PM eleminohet apo shfajësohet totalisht kur gabimi kryhet në kushtet e

- *injurancës (padijes) ose*
- *paaftësisë (pamundësisë).*

6. Pergjegjesia morale

■ Permbledhje- PM:

■ *Së treti PM lidhur me një gabim apo një dëmtim mund të lehtësohet nga rrethanat*

- *(1) e paqartësisë,*
- *(2) vështirësisë dhe*
- *(3) përfshirjes minimale (megjithëse mosveprimi nuk e zvogëlon PM, në se dikujt i është caktuar detyra që të ndalojë kryerjen e këtij lloj gabimi),*

- *shkalla në të cilën këto rrethana zvogëlojnë PM do të varet nga*
- *(4) serioziteti i gabimit ose demtimit.*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Etika e biznesit

- nje studim i specializuar në të drejtat dhe gabimet morale,

- trajton menyren se si zbatohen standardet morale

- ne politikat,
- ne institucionet dhe
- ne sjelljet e biznesit.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Shoqeria njerëzore përbehet nga njerzit, të cilët kanë synime e qëllime të përbashkëta.
- krijimi, edukimi dhe mbrojtja e jetës familjare;
- prodhimi dhe shpërndarja e të mirave materiale – ku mbështetet jeta njerëzore;
- kufizimi dhe rregullimi ligjor i përdorimit të forcës;
- Gjetja e menyrave për marrjen e vendimeve kolektive; dhe
- Krijimi dhe ruajtja e kultures, artit, njohurive dhe teknologjise

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Për plotësimin e qëllimeve njerzitet krijon modele relativisht të qëndrueshme të veprimtarisë -institucione:
 - “familjare”,
 - “ekonomike”,
 - “ligjore”,
 - “politike”, dhe
 - “institucionet e edukimit”
 - etj.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Institucionet ekonomike
- *Prodhimin e mallrave dhe te sherbimeve per te cilat kane nevoje anetaret e shoqerise, dhe*
- *Shperndarjen e te mirave materiale apo sherbimeve per anetaret e shoqerise.*
- kush do te realizoje prodhimin,
- si do te organizohet puna,
- cilat do te jene burimet,
- si do të shperndahen produktet dhe sherbimet per anetaret e shoqerise

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

■ Organizatat e biznesit:

■ janë institucione ekonomike, ku njerzit realizojnë prodhimin dhe shpërndarjen e mallrave e të shërbimeve.

■ përmbajnë strukturat fundamentale nëpërmjet të cilave anëtarët e shoqërisë bëjnë të mundur transformimin e burimeve të kufizuara - toka, puna e gjallë, kapitali dhe teknologjia – në të mira materiale të përdorëshme.

■ përmbajnë edhe kanalet përmes të cilave shpërndahen këto të mira materiale apo shërbime:- ne trajtën e:

- produkteve për konsumatorët,
- pagave për punonjësit,
- të ardhura për investuesit (furnizuesit) e kapitalit,
- tatimeve e taksave për qeverinë, etj.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Analiza e etikës së biznesit ka në fokus institucionet ekonomike (organizatat e biznesit)
- Studiuesi Raymond Baumhart në artikullin me titull **"Is the Business Ethics Changing"** (HBR). – ka bërë një përmbledhje të studimit të tij mbi etikën e biznesit
 - Ai ka intervistuar një numër të konsiderueshëm menaxherësh, të cilëve ju ka kërkuar të japin përgjigje për pyetjen "C'kuptoni me "etikë"?"
 - Nga përgjigjet e marra – rezulton se:
 - gjysma e të pyeturve e përkufizojnë këtë term si: *"ajo që ne ndiejmë se është e drejtë"*;
 - 25% e përkufizojnë me terma religjioze apo të besimit fetar, të tilla si *"etika është gjithashka që është në pajtim me besimin fetar"*; dhe
 - 18% e përkufizojnë *"etika është të vepruarit në pajtim me rregullin e artë"*.
- Cilat mendoni se do të ishin përgjigjet në mjedisin tonë?

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Fusha e etikës (së biznesit) tradicionalisht ka qënë “pronësuar” nga filozofët, akademikët dhe kritikët socialë.
- Format më të zakonshme të literaturës së etikës së biznesit në kohën e sotme përfshijnë:
 - **literaturën filozofike** që kërkon orientim dhe analiza të hollësishme;
 - **literaturën antologjike**, që kërkon shumë kohë, proces rishikimi dhe integrimi;
 - **rastet studimore** – (case studies), të cilat kërkojnë analizimin e një numri të madh rastesh të veçanta, harxhimin e një kohe të konsiderueshme, të nevojshme për të bërë sintetizimin e tyre; dhe
 - literaturën që fokusohet në **përgjegjësitë sociale**, ku përfshihen një mori shembujsh në lidhje me veprimet e mira apo të këqija të shoqërive të biznesit.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Ç'është etika e biznesit?
- Fare thjesht, etika e biznesit Kërkon që :
 - fillimisht të mësohet/të kuptohet se çfarë është e drejtë apo e gabuar, brenda kontekstit të organizatës së biznesit; dhe më pas
 - veprimin, në mënyrë të drejtë ose të gabuar.
- Megjithate dilemat që ndeshen në vendin e punës përgjithësisht janë të vështira e teper komplekse.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Format e gjykimit për mënyrën e veprimit (sjelljes) është diversive
 - ka eticienë që pohojnë se, bazuar në parimet morale, gjithmonë ekziston një gjë e drejtë që duhet kryer,
 - të tjerë eticiene besojnë se kryerja e një veprimi të drejtë varet nga situata - dhe ajo është një e drejtë e individit.
- Sidoqofte, janë të shumtë eticienët që i konsiderojnë besimet etike si pararendëse të hartimit të ligjeve e rregullave,

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Vlerat që na udhëzojnë se si duhet të sillemi - konsiderohen vlera morale:
 - respekti,
 - ndershmëria,
 - sinqeriteti,
 - përgjegjësia, etj.
- Ndersa pikëpamjet apo deklaratimet që tregojnë se si zbatohen këto vlera shpesh quhen **parime morale** apo etike.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- vëmendja ndaj etikës së biznesit është e rëndësishme sidomos gjatë periudhave kur ka ndryshime themelore (tranzicioni)
- vlerat e krijuara më parë, gjatë këtyre periudhave vihen në pikëpyetje dhe në dyshim.
- Mqs disa nga këto vlera nuk vijojnë të respektohen, nuk ekziston një busull e qartë morale që të udhëheqë liderat për zgjidhjen e dilemave komplekse.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Etika e sotme e biznesit fokusohet shumë në:
 - *Çështjet e çorientimit (keq udhëzimi) menaxherial*
 - *Konfuzionet morale*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

■ Çorientimi (keq udhëzimi) menaxherial

- shpjegon në thellësi praktikat ilegale, jo-etike apo të dyshimta, të menaxhereve individuale, apo të organizates së biznesit,
- Shkaqet, dhe
- mjetet që duhet të përdoren për t'i korigjuar.

■ *Konfuzionet morale*

- konflikti potencial i interesave,
- përdorimi i gabuar i resurseve,
- keqmenaxhimi i kontratave e marrëveshjeve

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Etika e biznesit - disiplinë e menaxhimit.
- kërkesa për më shumë përgjegjësi sociale
 - varfëria, krimi, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e barabarta, shëndeti publik dhe përmirësimi i arsimimit.
- Meqënëse realizimi i fitimeve të bizneset ven nga përdorimi i resurseve ekonomike të një vendit, ato (bizneset) kanë detyrime ndaj atij vendi

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Zhvillimi i shpejtë të disiplinës të etikës së biznesit lidhet me nevojën e organizatave të biznesit
- nevoja për të menaxhuar me një imazh më pozitiv ndaj publikut - bëri që të lindë **disiplina që trajton marrëdhëniet publike**.
- nevoja për një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore - bëri që të lindë disiplina e **menaxhimit të burimeve njerëzore**.
- Në analogji me sa më sipër u zhvillua edhe **disiplina e etikës së biznesit** - kur tregëtia filloi të bëhej më e komplikuar dhe dinamike, dhe organizatat e biznesit e kuptuan se ato kishin nevojë për më shumë udhëzime për të vepruar në kushtet e reja, me qëllim që të zhvillonin biznes dhe tregonin kujdes për mosdëmtimin e konkurrentëve.
- Kodet e etikës, të sjelljes, rolet e eticieneve dhe komiteteve të etikës, të politikave e procedurave

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Gjatë gjithë jetës së vet njeriu gjendet përballë dilemës për të vendosur se çfarë është "*e drejtë*", "*e duhur*" dhe "*sinqertë*".

Për analogji - gjatë kryerjes së punës, menaxherit i duhet të marrë në konsideratë mënyrat se si duhet t'i komunikojë lajmet e këqija me superiorët e tij, si të nxisë prodhimin ose shërbimin, me sa kujdes duhet të raportojë tek punëdhënësi i tij për shpenzimet e biznesit, si duhet të trajtojë vartësit, etj.

- trajtimi i të punësuarëve;
 - përcaktimi i çmimeve të produkteve dhe të shërbimeve;
 - mbrojtja e mjedisit;
 - permbushja e përgjegjësive sociale, etj.
- menaxheri duhet të japë gjykimin e tij për vendimet me karakter etik që merr organizata dhe, nëse ai nuk bie dakord me këto vendime, cilat duhet të jenë hapat e mëtejshme që duhet të ndërmerret.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

■ *Etika e biznesit:*

- *ka të bëjë me aftësinë për të gjetur të vërtetën, që rrjedh nga besimet bazë dhe për të vendosur me ndërgjegje mbi veprimet në kontekstin e biznesit.*
- *merret me zgjedhjen e lirë midis disa alternativave.*
- *Në një sens më praktik ...etika rrethohet nga integriteti dhe autenticiteti i biznesmenit dhe sipërmarrjes të biznesit.*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Etika e biznesit përfshin :
 - artin e integritit dhe të kompromisit dhe jo thjesht bindjen e konformitetin e verbër.
 - tolerancën ndaj paqartësive;
 - një proces ndërpersonal me veprim të orientuar..."
- trajton çështje që janë larg problemeve të thjeshta të ligjshmërisë ose të paligjshmërisë
- trajton gjithashtu, fenomenet e rryshfetit, të vjedhjes, apo të marrëveshjeve të fshehta.
- është një mënyrë e jetës dhe jo një varg parimesh absolute të shkëputura nga jeta jonë e përditëshme

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Pse ka rëndësi të sillemi në mënyrë etike, kur mund të ndodhë që sjellja jo etike të na japë avantazhe në botën konkurruese të biznesit?
 - *Së pari*, sjellja jo etike mund të ketë pasoja dëmtuese serioze
 - *Së dyti*, sjellja etike zakonisht ka pasoja të rëndësishme pozitive
 - *Së treti*, sjellja juaj shërben si model për ju dhe për të tjerët

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- *Së katërti*, gabimet etike bëjnë që karrierat profesionale të përfundojnë shumë më shpejt dhe në mënyrë më përfundimtare
- *Së fundi*, sjellja etike në vetvete mbart vlerë.
- Përfundimisht, nevoja për sjellje etike mund të shprehet më mirë nëpërmjet shprehjes popullore se "*atë që do të hedhësh do të presësh*"

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- tre mënyrat kryesore të vendimarrjes etike në biznes.

Analiza ekonomike - i bazon gjykimet etike në forcat e tregut - maksimizimi i të ardhurave dhe të minimizimi i kostove. **njerëzit konsiderohen si mjete për të arritur qëllimet dhe nuk mbahet parasysh natyra e tyre.**

- *Analiza ligjore* - e redukton gjykimin etik thjesht në një çështje që lidhet me ligjin - çdo gjë që është e paligjshme është jo - etike.
- *Analiza filozofike* duket më komplekse dhe më e përshtatshme se dy të parat në dhënien e udhëzimeve të dobishme për marrjen e vendimeve etike.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Pikëpamjet kryesore filozofike
- *Pikëpamja religjioze ose e besimit.*
 - çdo besim fetar ka urdhëra bazë morale dhe shpirtërore, të cilat mund të përdoren për të vlerësuar etikën e një sjelljeje të dhënë.
 - Shumica e religjioneve na mësojnë se sjellje të tilla si gënjeshtria, tradhëtia bashkëshortore, shpifja, vrasja etj. Nuk janë të moralshem (janë të padrejta).
- *Pikëpamja e dobishmërisë (utilitariane).*
 - një sjellje është etike në qoftë se ajo siguron përfitimet më të mëdha për një numër gjithnjë e më të madh njerëzish.
- *Pikëpamja Universale.*
 - fokusimi duhet të bëhet tek qëllimi.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

■ *Pikëpamja humaniste:*

- Sipas Aristotelit “veprimet e vërteta humane kanë qënë kryer nga persona racionalë, individë që dinin se çfarë bënin dhe e zgjidhnin lirshëm atë që bënin”

■ *Pikëpamja politiko-kulturore.*

- Brenda një konteksti të dhënë politik dhe kulturor, ekzistojnë një sërë vlerash dhe procesesh që paraqiten si bazë për mirëqënien dhe rritjen e shoqërisë që përcaktojnë standardet që shërbejnë për të gjykuar sjelljen tonë dhe sjelljen e të tjerëve.

■ *Pikëpamja dialoguese:*

- qëndrimet që mbajnë individët gjatë komunikimit me njeri-tjetrin shprehin deri diku një lloj indeksi të nivelit etik që përmbahet në këtë komunikim.

■ *Pikëpamja situacionale.*

- përcaktuese janë veçanërisht parashikimet që pritet të arrihen si edhe nivelet e njohurive që shërbejnë për të vlerësuar e gjykuar.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Vlerat në tranzicion dhe lidhshipi organizativ.
- Në themel të çdo pikëpamjeje etike qëndron një sistem vlerash, që shërben si një guidë për të gjykuar sjelljen tuaj dhe atë të tjerëve e që si rregull, i reziston ndryshimeve.
- vijnë nga disa burime:
 - familja,
 - institucionet (kisha, shkolla),
 - eksperiencat e mëparshme (trainimet, sukseset, pakënaqesitë),
 - media (tv, radio, librat, gazetat dhe revistat),
 - rolet profesionale dhe modelet,
 - politika e organizimit të biznesit si dhe kodet tona personale të etikës (të zhvilluara përmes eksperiencës me konflikte etike dhe presione të ndryshme).

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- sistemi i vlerave, ndaj të cilit ne jemi të ekspozuar, mund të ndryshojë duke sjellë ndryshim në sjelljen njerëzore dhe komunikimin.
- brenda shoqërisë tonë vlerat janë në gjendje tranzicioni.
- në shumicën e shoqërive të industrializuara ato po ndryshojnë sipas kahjeve të mëposhtme:
 - nga arritja tek vetëaktualizimi;
 - nga vetëkontrolli tek vetëshpallja;
 - nga pavarësia tek ndërvarësia;
 - nga durimi i njerëzimit tek ftesa për kënaqësi dhe gëzim;

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- Disa nga mitet dhe përfitimet që rrjedhin nga etika e biznesit
- Etika e biznesit në vendin e punës synon të japë prioritetin e duhur për vlerat morale dhe shërben për të siguruar e garantuar që sjelljet respektive do të jenë në pajtim me keto vlera – kjo i shton vlerë menaxhimit.
- Pavarësisht kësaj, në etikën e biznesit mitet vazhdojnë të jenë të pranishëm dhe me bollëk. Ato burojnë nga.
 - konfuzioni i përgjithshëm që ekziston rreth vetë nocionit të etikës.
 - nga ngushtimi ose shikimi i thjeshtëzuar i dilemave etike.

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- *Etika e biznesit më tepër është çështje e besimit fetar se sa çështje e menaxhimit.*
- *Të punësuarit e organizatës së biznesit duhet të sillen në mënyrë etike natyrshëm, kështu që nuk ka nevojë të fokusohet vëmendja ndaj etikës së biznesit.*
- *Etika e biznesit është një disiplinë e cila trajtohet më shumë nga filozofët, akademikët dhe teologjistët.*
- *Etika e biznesit është e tepërt – ajo vetëm sa pohon atë që dihet ose faktin që “veprimet duhet të bëhen mirë.*
- *Etika e biznesit është një çështje e njerëzve të mirë që ju predikojnë po njerëzve të mirë.*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- *Etika e biznesit përbën një fenomen të ri me natyrë policore që paraqitet në trajtën “en block”.*
- *Etika e biznesit nuk mund të menaxhohet.*
- *Etika e biznesit dhe përgjegjësia sociale janë e njëjta gjë.*
- *Organizata jonë nuk shqetësohet (nuk ka probleme) për zbatimin e ligjeve, gjë që do të thotë se ne veprojmë në mënyrë etike.*
- *Menaxhimi i etikës në vendin e punës ka të bëjë pak me praktikën.*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- 10 përfitimet që rrjedhin nga menaxhimi etik në vendin e punës.
- *Vemendja që i është kushtuar etikës së biznesit ka ndikuar që shoqëria të përmirësohet në mënyrë thelbësore.*
- *Programet etike ndihmojnë që edhe në kohët më të turbullta të ruhen drejtimitet e duhura morale.*
- *Programet etike kultivojnë punën në grup dhe produktivitetin.*
- *Programet etike mbështetin përmirësimin e njohurive dhe rritjen e nivelit të të punësuarëve.*

7. Etika e biznesit, Konceptet bazë dhe objekti

- *Programet etike shërbejnë si politika garantuese – ato ndihmojnë për të siguruar që, gjithashtu, politikat apo metodat e zbatuara janë të perfshira*
- *Programet etike ndihmojnë për të mënjanuar veprimtaritë kriminale, “mangësitë” – ato ndihmojnë për të zvogëluar penaltitetet.*
- *Programet etike ndihmojnë për të menaxhuar vlerat që lidhen me cilësinë e menaxhimit, planifikimin strategjik dhe menaxhimin e ndryshimit – përfitim i cili kërkon më shumë vëmendje.*
- *Programet etike nxitin për të krijuar një imazh më të mire të organizatës tek publiku*
- *Nga programet etike merren përfitime të përgjithëshme. Menaxhimi i vlerave etike në vendin e punës i legjitimon veprimet menaxheriale*
- *Vëmendja formale ndaj etikës në vendin e punës është gjeja më e drejtë që duhet bërë.*



■ **FALEMINDERIT!**